



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-2599/23
Kaçanik, 31.01.2023

Në bazë nenit 13.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 – për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31 janar 2023, mori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA, PËR VITIN 2022

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 060/01-2599/23 me tekstin e mëtejshëm, Raporti i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2022, i hartuar nga Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.
2. Në Raportin e Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, është paraqitur aktiviteti i zhvilluar i këtij komiteti përmes mbledhjeve të rregullta dhe aktiviteti tjetër, me qëllim të arritjes së përmirësimit të gjendjes së personave me aftësi të kufizuara në komunën e Kaçanikut.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Raporti i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, i përmbledhur në gjithsej 8 faqe.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara Kryetari i Komunës, dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	30.01.23	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01-060/01-2599/23				

Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

Republika Kosova

Opština Kaçanik

Republic of Kosovo

Municipal Kaçanik

Raport i Punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara për vitin 2022

Kaçanik, 2023

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	2
Lista e shkurtesave.....	3
Fjala e Zëvendës Kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara.....	4
Korniza Ligjore.....	5
I. Mbledhjet.....	6
II. Hartimi i Planit të Punës 2021.....	6
III. Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2021.....	7
IV. Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme	7
V. Aktivitete avokuese.....	8

Lista e Shkurtesave

PAK – Personat me Aftësi të Kufizuara

PLVPAK – Plani Lokal i Veprimit Për Personat me Aftësi të Kufizuara

KKPAK – Komiteti Konsultativ Për Personat me Aftësi të Kufizuara

Fjala e Zëvendës Kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

I nderuari Kryesues i Kuvendit Komunal të Kaçanikut, Z. Kemajl Murseli,


Të nderuar anëtar,

Ne si Komitet paraqesim raportin e punës përgjatë vitit kalendarik 2022 për të cilin na obligon legjislacioni në fuqi, në raport me KKPAK-në përkatësisht Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr-01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna. Komiteti përfaqëson interesat e komunitetit të PAK-së në Komunën e Kaçanikut, jemi munduar që punën tonë ta fokusojmë në avancimin e çështjes së aftësisë së kufizuar duke ngritur vetëdijen për gjendjen në të cilën gjindet ky komunitet dhe nevojat e kësaj kategorie dhe intervenimet të cilat duhet t'i kemi si në sferën institucionale por edhe të shoqërisë.

Të nderuar anëtarë, funksionimim e komitetit e ka vështirësuar për të mos thënë e ka bërë të pamundur dorëheqia e tre anëtarëve, ku funksionimi i komiteti me vetëm 4 anëtarë e ka bërë të vështirë edhe mbajtjen e takimeve të komitetit sepse të gjithë anëtarë kanë qenë të angazhuar në aspekte profesionale dhe mungesa e vetëm njërit anëtarë e ka pamundësuar mbledhjen e kourumin për mbajtjen e takimeve të komitetit. Ky shqetësim është adresuar me kohë tek personat kompetent por nuk janë gjetur mundësi për pranimin e anëtarëve të rinjë në komitet.

Ne si komitet shpresojmë në një bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitutional, për avancimin e çështjes së aftësisë së kufizuar në Komunën e Kaçanikut, ngase sfidat me të cilat ballafaqohen personat me nevoja të veçanta por edhe familjet e tyre janë të mëdha dhe vështirë të përballueshme.

Me respekt, Mirlinda Hysa



Korniza Ligjore

Komitetet Konsultative janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, roli i të cilave është që përmes këtyre komiteteve të garantohet që organet e komunave të jenë më transparente, më efikase dhe t'u japin më shumë llogari qytetarëve. Si të tilla ato mund të angazhohen në: dhënien e propozimeve për rregullore të ndryshme; hulumtime të ndryshme; japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmara nga kryetari i komunës, komitetet e përherëshme apo kuvendi i komunës në fushën përkatëse; paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te kryetari i komunës dhe kuvendi i komunës; japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Baza e funksionimit të këtyre komiteteve mbështetet në këto dokumente ligjore: Ligjin Nr 03/L-40 Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

Përbërja:

Mirlinda Axhami Zv- Kryesuese

Antigona Axhami Anëtare

Edita Shehu Anëtare

Fiknete Krasniqi Anëtare

Mbledhjet

KKPAK ka mbajtur vetëm një mbledhje gjatë këtij viti, duke mos përmbushur kuotën normative prej 6 mbledhjeve brenda një viti siç janë përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna. Kjo mungesë e mbajtjes së mbledhjeve ka ardhë si pasojë e numrit të vogël të anëtarëve në komitet, vetëm 4, por edhe si pasojë e angazhmit profesional të anëtarëve të komitetit edhe jashtë Komunës së Kaçanikut.

Mbledhja e parë është mbajtur me datën 18.03.2022 dhe është shqyrtuar ky rend dite:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e parë Komitetit Konsultativ të PAK për vitin 2022;
2. Situata në të cilën ndodhet komiteti pas dorëheqjes së dy anëtarëve
3. Miratimi i planit të punës
4. Diskutim për 21 marsin
5. Të ndryshme

Hartimi i Planit të Punës për vitin 2021

Janë zhvilluar takime joformale nga anëtarët e komitetit për hartimin e planit të punës për vitin 2022, i cili plan është hartuar dhe miratuar në mbledhjen e mbajtur në muajin mars.

Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2018-2021

Monitorimi i planit të veprimit ka qenë i paraparë edhe me plan pune, për të kuptuar situatën e implementimit të planit deri në fund të vitit 2021 sa edhe ishte valid ky plan. Pas aktiviteteve të shumta të realizuara për monitorimin e planit nëpërmjet takimeve dhe intervistave të drejtpërdrejta me bartësit e institucioneve lidhur me objektivat e parapara në këtë dokument por nëpërmjet vrojtimit të drejtpërdrejtë.

Vlenë të ceket që ky plan nuk është realizuar në pjesën më të madhe, me disa përjashtime në kuadër të DKA-së ku është rritur numri i asistentëve të fëmijëve me nevoja të veçanta, rritjen e stafit profesional në shkolla si dhe iniciativa për ndërtimin e ashensorit në Gjimnazin “Skënderbeu”

Tani Komuna e Kaçanikut nuk ka një dokument strategjik për avancimin e çështjes së aftësisë së kufizuar, dhe kjo përbën një shqetësim për ne dhe akterët e tjerë që avokojnë për aftësinë e kufizuar.

Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme

Si anëtarë të komiteti i jemi përgjegjgur gjithmonë ftesave për të qenë të pranishëm në takime dhe aktivitete të çështjes së aftësisë së kufizuar.

Më datën 1 qershor 2022 kemi qenë të pranishëm me rastin e hapjes së bibliotekës së lodrave në Kaçanik ku kemi diskutuar për rëndësinë e lodrave në zhvillimin e fëmijëve në aspektin psikologjik, social dhe emocional.

Aktivitete avokuese

Anëtarët e KKPAK-së kanë mbajtur ligjërata vetëdijësuese në shkolla të ndryshme të komunës me 21 mars, 1 prill dhe 3 dhjetor.

21 mars, Dita Ndërkombëtare e Sindromës Down

Anëtarja Edita Shehu me 21 mars në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down ka mbajtur ligjërata vetëdijësuese në:

SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik me nxënësit duke filluar nga klasët e para e deri në klasët e nënta.

Po ashtu, ligjërata janë mbajtur në SHFMU “Kadri Zeka” në Dubravë dhe SHFMU “Jusuf Gërvalla” nga anëtarë tjerë të komitetit.

1 prilli - Dita Ndërkombëtare e Autizmit

Anëtarja e komitetit Edita Shehu mbanë ligjërata vetëdijësuese në SHFMU “Idriz Seferi” Bob më klasët 5,6,7,8, në SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik me klasët 5,6,7,8,9 si dhe në SHFMU “Emin Duraku” në Runjevë me klasët 1,2,3,4,5.

Ligjërata janë mbajtur edhe në SHFMU “Kadri Zeka” nga sociologjia Antigona Axhami si dhe në SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec me klasët 8 dhe 9.

3 dhjetor, Dita Ndërkombëtare e Personave me aftësi të kufizuar

Në këtë ditë mbahen ligjërata vetëdijësuese në SHFMU “Jusuf Gërvalla” Biçec dhe Nikaj me klasët e 8 dhe 9 ta.